



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN), më datë 06.11.2014, realizoi vizitë për rikontroll në Burgun Manastir. MPN-ja këtë vizitë e realizoi në shoqërimin e bashkëpunëtorit të jashtëm të Shoqatës për të Drejtën Penale dhe Kriminologji, në bazë të nënshkrimit paraprak të Memorandumit për bashkëpunim.

Vizita në burg u realizua në disa hapa. Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional, fillimisht zhvilloi bisedë me ekipin udhëheqës të Burgut Manastir të drejtuar nga drejtori dhe më pas zbatoi këqyrje në Repartin e hapur, gjysmë të hapur, të mbyllur dhe në Repartin e Pranimit, pjesën e paraburgimit, dhomat e izolimit, ambulancë, zhvilloi bisedë me Sektorin për Risocializim, si dhe bëri këqyrje në dosjet profesionale.

Gjatë vizitës për rikontroll u vlerësua se nga rekomandimet paraprakisht të dhëna, 7 janë zbatuar, 2 janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 6 prej tyre nuk janë zbatuar.

Gjatë kohës së vizitës për rikontroll MPN-ja pranoi më shumë ankesa për keqtrajtim dhe trajtim johuman nga ana e Sektorit për Sigurim. Kjo informatë u pranua nga pjesa e paraburgimit dhe me të njëjtën u njoftua edhe udhëheqësi.

Gjatë vizitës për rikontroll u konstatua se nuk plotësohen vendet vakante të të punësuarve në burg dhe se realisht numri i të punësuarve është problem i cili mund të ndikojë mbi procesin e risocializimit. Gjatë periudhës së kaluar, Ministria e Financave ka refuzuar pranimin e 3 personave, përkatësisht nuk ka dhënë pëlqim për punësime.

Njëri nga konstatimet më të rëndësishme nga vizita paraprake e MPN-së ishte se në Burgun Manastir nuk zbatohet procesi arsimor, i cili konform LES duhet të organizohet nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Kjo u konfirmua edhe gjatë vizitës për rikontroll, sepse as në burg e as jashtë tij nuk realizohet njëra nga të drejtat më elementare të personave të dënuar dhe njëkohësisht njëri nga faktorët më të rëndësishëm për risocializimin e suksesshëm të përcaktimeve të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve.

Burgu ka automjete joadekuate për shoqërim, të cilët datojnë para vitit 2001. Një pjesë e tyre nuk janë të sigurta si për personat e privuar nga liria, ashtu edhe për vet shërbimet të cilët e zbatojnë shoqërimin. Në pjesën e evidencës ekziston praktikë pozitive e evidentimit të lëndimeve të personave të arrestuar të cilët shoqërohen nga nëpunësit policorë. Libri i ndëshkimeve disiplinore udhëhiqet me rregull.

Si rezultat i vizitës së realizuar, Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional përpiloi raport në të cilin e konstatoi nivelin e rekomandimeve të zbatuara dhe u dha sugjerime përkatëse Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe Burgut Manastir.